



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANËS DURRËS

Nr. 3278 Prot.

Durrës, më 27/02/2025

Lënda: Kërkesë për Shpallje Publike

Drejtuar: DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë

Në vijim të marrjes së masave për Rikuperimin me Forcë të Borxhit Doganor, mbështetur në Ligjin "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr.15 datë 03.12.2018 të D.P.D-së "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës", Kreu VI "Njoftimi i Vendimit", pika 3, b) "Rastet e mos marrjes së konfirmimit të njoftimit", si dhe në zbatim të nenit 130-141/a të Kodit të Procedurës Civile, Ju drejtohem për të mundësuar njoftimin e subjektit debitor të poshtëshënuar pasi nga ana jonë nuk është mundësuar Njoftimi i Vendimit Administrativ të Degës së Doganës Durrës:

Nr	Vendimi Administrativ		Subjekti debitor		Detyrimi	Penalitete	SHUMA
	Nr.	Data	Emri	Nipti			
1	87	07.02.2025	SAIMIR LUSHAKAJ	J00611050C	781,085	2,343,255	3,124,340

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

KRYETARI
DENIS SHABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE DURRËS

Nr. 9113 Prot.

Durrës më 07.02 2025

V E N D I M N R. 87

Sot, me datë 07.02.2025, Kryetari i Degës së Doganës Durrës, pasi shqyrtova materialin e plotë bashkëngjitur shkresës së Drejtorisë së Hetimit pranë Departamentit Operativ Hetimor në DPD me nr. 20812/2 Prot., datë 13.01.2025 (nr.637 Prot., datë 14.01.2025 i DDD) për shkeljen e kryer nga ana e shtetasit « Saimir Lushakaj » me Nipt. J00611050C

K O N S T A T O V A S E:

Në datën 04.05.2020 pranë Sektorit Operacional të DDD, Zyra e Trageteve është paraqitur Agjensia Doganore « Log In Albania » me Kod J029 dhe si përfaqësues i tërthortë i shtetasit « Saimir Lushakaj » me Nipt. J00611050C për të deklaruar për qarkullim të lirë mallin « mjet tip Mercedes Benz G63 AMG, me fuqi motorrike 3982cc, me numër shasie WDB4632761X323764 », me kod tarifor *87033390* me peshë bruto/neto 2560 kg, me vlerë 80 000 euro përkatësisht deklarata doganore Imp.4 R. 33649, datë 04.05.2020. Për këtë mall janë paguar detyrimet doganore në shumën 2 101 275 lekë.

Referuar procesverbalit të verifikimit të kontrabandës të mbajtur nga ana e Drejtorisë së Hetimit pranë DOH-së në DPD me nr. 0001372, datë 08.01.2025 rezultoi se nga ana e deklaruesit janë paraqitur dokumenta të rreme, me qëllim shmangien e detyrimeve doganore që duhen paguar realisht për mallin e deklaruar në qarkullim të lirë që ka vlerë reale 110 000 euro, krahasuar me dokumentacionin të disponuar nga subjekti deklarues dhe atyre të vëna në dispozicion nga Autoritetet Doganore Gjermane, shkresa e Drejtorisë së Hetimit me nr. 20812/1 Prot., datë 22.10.2024 përmes së cilës është përcjellë dokumentacioni dhe informacioni i aurdhur nga A. D. Gjermane për deklaratën e eksportit me nr. MRN20DE535527018498E5, datë 01.05.2020.

Për këtë qëllim janë përllogaritur detyrimet shtesë të lindura si rezultat i deklarimit të një vlerë me të ulët në shumën 781 085 lekë, dhe në bazë të nenit 178-181, 250, 266, 267, 268 është propozuar penalitet në masën 3 fish të detyrimit doganor në shumën 2 343 255 lekë.

Ky konstatim i është dërguar për njoftim shkelësit me shkresën nr. 637/1 Prot., datë 15.01.2025, përmes shërbimit postar, në adresën e deklaruar dhe të siguruar përmes Ealbania.

Mbështetur në shkresën me nr. 20812/2 Prot., datë 13.01.2025 (nr.637 Prot., datë 14.01.2025 i DDD) për shkeljen e kryer nga ana e shtetasit « Saimir Lushakaj » me Nipt. J00611050C dhe Procesverbalit për verifikimin e Kontrabandës me nr. 0001372, datë 08.01.2025 të Departamentit Operativ Hetimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, u arrit në konkluzion se nga ana e shtetasit « Saimir Lushakaj » me Nipt. J00611050C është kryer shkelja e kontrabandës në fushën e doganave, me zgjidhje administrative shkelje kjo e parashikuar në Dispozitat e Kodit Doganor.

Për sa më sipër, në bazë të nenit, 178-181, 250, 266, 267, 268, 270, 273 e vijues, 276 të Ligjit nr. 102/2014, date 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH”, të VKM -së nr. 651, datë 10.11.2017 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Ligjit nr. 102/2014, datë 31.07.2014”; si dhe çdo Urdhëresë e DPD-së që nuk bie në kundërshtim me Ligjin nr. 102/2014, date 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH”;

V E N D O S A :

1. Shtetasi « Saimir Lushakaj » me Nipt. J00611050C të marrë masa për pagesën e detyrimeve doganore në shumën **781 085 lekë** për deklaratën doganore Imp.4 R. 33649, datë 04.05.2020;
2. Të dënojë me gjobë shtetasin « Saimir Lushakaj » me Nipt. J00611050C sa 3- fishi i detyrimit doganor që duhen paguar në shumën **2 343 255 lekë** ;

proceduar më tej në zbatim të procedurave përkatëse të normuara nga aktet ligjore në fuqi ngarkohen: Përgjegjësi i Operacioneve Doganore, Sektori i Trageteve, Zyra e Financës, Zyra e Borxhit, Zyra e Aposteriori.

4. Kundër këtij vendimi mund të ushtroni ankim pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave sipas nenit 281 e 282 të Kodit Doganor në fuqi. Kërkesa ankimore e arsyetuar duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të këtij vendimi duke paguar shumën e përgjithshme të detyrimeve të importit/eksportit si dhe duke garantuar për DPD-në shumën e sanksioneve të aplikuara për këtë shkelje.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Denis SHABANI

KRYETAR

